

Mbështetje për gazetari investigative: "Raportim në situata krizash"

Në periudhën nga qershori deri në shtator të vitit 2017, Rrjeti i Evropës Juglindore për Profesionalizimin e Mediave (SEENPM) dhe Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) do të mbështesin gazetarë nga rajoni përmes organizimit të trajnimit për raportim në situata krizash dhe prodhim të gazetarisë investigative. Në kuadër të programit do të ndahet mbështetje financiare individuale për raportimin e temave që lidhen me situata krizash.

Në kontekstin e projektit, situata e krizës nënkupton polemikat dhe/ose mospajtimet e ashpra ndërmjet aktorëve të rëndësishëm shoqërorë, ku para së gjithash mendohet për strukturat politike në pushtet, si një prej subjekteve kryesore në raportime. Në këtë drejtim, qëllimi është që të theksohet rëndësia dhe përgjegjësia e mediave si një prej faktorëve kyç për debat publik demokratik që mund të ndikojnë në përmbylljen e krizave. Shembuj për situata të krizave janë protestat e qytetarëve, kriza politike, skandalet e mëdha të korrupsionit, etj. Situata të krizave mund të konsiderohen dhe ato të gjeneruara nga strukturat qeverisëse ose nga opozita. Gjithashtu, subjekt i analizës mund të jenë çështjet ndërkombëtare të vëna në kontekst kombëtar, siç është kriza e refugjatëve, terrorizmi ose katastrofat natyrore, të cilat janë të shoqëruara me debate ku pushtetet luajnë rol të rëndësishëm.

SEENPM dhe ISHM i ftojnë të gjithë gazetarët e interesuar që të paraqiten për programin
"Raportim në situata krizash"

Kush mund të aplikojë?

Për pjesëmarrje në programin "Raportim në situata krizash" mund të paraqiten gazetarë nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Kosova, dhe Maqedonia.

Programi për mbështetje: Mbështetja individuale do të jepet për prodhimin e raportimeve, qëllimi i të cilave është që të nxjerrin në pah dezinformimin në një situatë të caktuar krize, duke nxitur nevojën për gazetari të besueshme dhe të angazhuar në një shoqëri demokratike. Në fokusin e programit janë temat që nuk janë investiguar ose janë investiguar në mënyrë të përciptë. Përmes programit është planifikuar të mbështetet prodhimi i gjithsej 18 raportimeve (18 gazetarë nga 6 vende).

Formati i raportimeve investigative: Teksti bazë i raportimeve investigative duhet të jetë i shoqëruar me foto dhe/ose video, ose me të dhëna të vizualizuara, duke i bërë, kështu, raportimet të përshtatshme për publikim në platforma të ndryshme.

Afatet për realizimin e raportimeve investigative:

- Drafti i parë: 13 gusht 2017;
- Drafti i dytë: 31 gusht 2017;
- Afati i fundit për botim: 15 shtator 2017.

Raportimet do të botohen në mediat ku punojnë gazetarët-pjesëmarrës në program, si dhe në media të tjera në të gjashtë vendet.

Detyrimet e pjesëmarrësve në program:

- **Trajnim: 6 - 8 qershor 2017, Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë.** Aplikantët e përzgjedhur duhet të marrin pjesë në trajnimin që do të mbahet nga 6 deri në 8 qershor 2017 në Tiranë. Gjatë kohës së trajnimit do të caktohet metodologjia dhe dinamika e punës për secilin projekt investigativ dhe do të caktohet procedura e punës. Trajnimi do të zhvillohet në gjuhën angleze.
- **Bashkëpunim me ekipin redaktues (12 qershor-12 shtator).** Gazetarët duhet të bashkëpunojnë me ekipin redaktues të programit. Bashkëpunimi nënkupton tre konsultime në faza të ndryshme të procesit investigativ. Raportimet do të botohen pasi ekipi redaktues dhe autori të bien dakord për versionin e fundit. Ekipi redaktues do të jetë në dispozicion të autorëve gjatë kohës së programit. Tekstet do të shkruhen në gjuhën amtare të gazetarit.

Afati dhe mënyra e paraqitjes:

Gazetarët e interesuar duhet të dërgojnë jo më vonë se dt.**8 maj 2017**:

1. *Biografi të shkurtër/CV* (ku të theksohen kurset dhe trajnimet në të cilat kanë marrë pjesë kandidatët, sidomos ato të lidhura me gazetarinë investigative)
2. *Aplikimin*, ku duhet të theksohet:
 - Tema e propozuar (maks. 200 fjalë) që do të jetë lëndë e investigimit –problemi, çështja së cilës investigimi duhet t'i japë përgjigje dhe përse është tema e rëndësishme (fokus i projektit janë temat që nuk janë investiguar fare ose jo mjaftueshëm);
 - Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë - i të dhënave që do të shqyrtohen, personat që do të intervistohen, burimet që do të konsultohen e kështu me radhë (maks. 200 fjalë);
 - Përshkrimi i formatit sipas të cilit do të prodhohet tregimi (tekst, foto, video, vizualizim i të dhënave);
 - Po qe se ka mundësi për botim në disa media, të përmenden dhe mediat.

Aplikimet duhet të dërgohen në adresën e e-mail-it: ilda@institutemedia.org, me subjektin: "Aplikim për programin - Raportim në situata krizash".

Kandidatët e paraqitur do të njoftohen për statusin e tyre deri më **12 maj 2017**.